



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ

Numri i lëndës: 2019:152726

Datë: 01.11.2021

Numri i dokumentit: 02395363

C.nr.791/19

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ, Departamenti i Përgjithshëm, gjyqtarja Mirlinda Bytyqi Rexhepi në çështjen juridike kontestimore të paditësit S.P. nga fsh... Komuna Ferizaj dhe H.P. nga fsh... Komuna Ferizaj, të cilën i përfaqëson me autorizim av.Gazmend Rexhepi nga Ferizaj, kundër të paditurit Xh.P. nga fsh... K. Ferizaj, të cilin e përfaqëson me autorizim Av.Ekrem Agushi nga Prishtina, baza e kontestit vërtetimin e bashkëpronësisë, pas mbajtjes së seancës kryesore publike në prani të autorizuarit të paditësit si dhe të paditurit, me dt. 05 tetor 2021 mori, ndërsa me datë 1 nëntor 2021 përpiloi me shkrim këtë:

A K T G J Y K I M

I.APROVOHET në tërësi kërkesëpadia e paditësve S.P. nga fsh ... K.Ferizaj dhe H.P. nga fsh ... K.Ferizaj, kundër të paditurit Xh.P. nga fsh ... K.Ferizaj, për vërtetimin e bashkëpronësisë, **si e bazuar.**

II.VËRTETOHET se paditësit S.P. dhe H.P. nga fsh.... K.Ferizaj janë bashkëpronarë me të paditurin me 1/3 në paluajtshmërinë kontestuese të ngastrave kadastrale ... ZK Varosh me sipërfaqe prej 4209m² dhe ... ZK Ferizaj me sipërfaqe 3584 m², tokë bujqësore, lloji i shfrytëzimit arë e klasit të tretë.

III.OBLIGOHET i padituri Xh.P. nga fsh.... K.Ferizaj, që t'ia pranoj dhe t'ia lejoj paditësve që paluajtshmërisë e cekur në piken **II** të dispozitivit, të regjistroj- bart në emër të tyre si bashkëpronar, në të kundërtën ky aktgjykim të njëjtit do t'i shërbej si titull ekzekutiv për regjistrim.

IV.OBLIGOHET i padituri që të paguan shpenzimet procedurale paditësve në shumë prej 730 euro, në afatin prej 15 ditësh prej kohës së plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit.

A r s y e t i m

Paditësit S.P. dhe H.P. nga fsh ... K.Ferizaj përmes të autorizuarit të tij me datë 16.07.2019 kanë ushtruar padi kundër të paditurit Xh.P. nga fshati ... K.Ferizaj për vërtetimin e bashkëpronësisë me të cilën kanë kërkuar që të vërtetohet sipas bazës së blerjes së përbashkët të parcelës se janë bashkëpronar të pronësisë së paluajtshme të ngastrave kadastrale ... me sipërfaqe 4209 m² dhe pastaj me datë 09.08.2019 ka bërë zgjerimin e kërkesëpadisë edhe sa i përket dhe parcelës ... me sipërfaqe 3584m², tokë bujqësore, lloji i shfrytëzimit arë e klasit të tretë, pronë private ZK Varosh.

I autorizuari i paditësit përmes padisë, seancave dhe fjalës përfundimtare ka deklaruar se mbetet pranë padisë dhe kërkon që e njëjta të aprovohet si e bazuar dhe kjo në bazë të provave dhe fakteve që janë administruar në shqyrtimi gjyqësore. Në bazë të ekspertizës e cila përputhet me skicën që e kanë dorëzuar në padi, po ashtu edhe me daljen në terren është parë që paditësit vetëm juridikisht nuk figurojnë si bashkëpronarë, ndërsa praktikisht janë shfrytëzues të 1/3 të parcelave të cilat janë objekt kontesti, po ashtu edhe paditësi i dytë i dëgjuar në cilësinë e dëshmitarit ka sqaruar me detaje historikun e këtyre parcelave. Gjykatës si provë i kanë dorëzuar edhe transferin e mjeteve financiare, ku si dëshmi është se këto parcela janë blerë bashkarish nga palët ndërgjyqëse, andaj duke u bazuar në provat e paraqitura kërkojnë nga gjykata që ta aprovojë padinë dhe parcelat ... dh ... ZK Varosh K Ferizaj të figurojnë si bashkëpronarë edhe paditësit S. dhe H.P. Gjithashtu kërkojnë edhe shpenzimet e procedurës dhe atë për tri seanca gjyqësore nga 135€, në emër të padisë 104€, në emër të taksës 21€ dhe në emër të ekspertizës 200€.

I autorizuari i të paditurit në përgjigje në padi ka deklaruar se padia e paditësit nuk është e rregullt me arsyetimin se nuk i përmban të gjitha elementet të cilat janë përcaktuar me dispozitat e neni 253 al.1 pika a,b dhe c. Ka deklaruar se padia e paditësit është e pabazuar dhe si e tillë do të duhej të refuzohet me arsyetimin se paditësit nuk ia kanë bashkangjitur padisë asnjë provë nga e cila do të vërtetoheshin faktet me rëndësi për fitimin e së drejtës së bashkëpronësisë në palujtshmërinë kontestuese, ngase kjo palujtshmëri është blerë nga i

padituri dhe e njëjta është regjistruar në pronësi të paditurit, ndërsa paditësit në këtë palujtshmëri nuk kanë kurrfarë të drejte pronësore pasi që me asnjë veprim nuk kanë kontribuar në krijimin e kësaj palujtshmërie.

Pasi që përfaqësuesi i të paditurit nuk ishte paraqitur në seancën e datës 05.10.2021, i padituri ka deklaruar se nuk ka nevojë të shtyhet seanca pasi që i padituri do të deklarohet personalisht për këtë çështje, duke shtuar se e kundërshton në tërësi padinë e paditësve si të pa bazuar me arsyetimin se ato prona i ka blerë vet. Nuk e konteston faktin se paditësit kanë kontribuar me mjete monetare por ato i ka kërkuar si borxh për blerjen e pronës dhe ato para të njëjtëve do të ua kthej, duke kundërshtuar se ato prona të ndahen në bashkëpronësi me nga 1/3, i propozon gjykatës që padia e paditësve të refuzohet si e pa bazuar gjithashtu i kundërshton edhe shpenzimet e procedurës.

Gjykata për të vërtetuar drejtë gjendjen faktike në këtë çështje kontestimore në procedurën e provave bëri administrimin e këtyre provave: Certifikata e pronësisë në emër të Xh.P., transaksion bankar, skica e planit, kontratë mbi shitblerjen palujtshmërisë e datës 09.11.2001, përgjigje në padi e datës 3.09.2019, ekspertizë e gjeodezisë datë 03.03.2021, parashtresë mbi zgjerimin e padisë dat 09.08.2019.

Pas vërtetimit të provave një nga një në mënyrë të ndërgjegjshme dhe të kujdesshme e të gjitha së bashku konform nenit 8 të LPK-së, deklarimeve të autorizuarve të palëve, gjykata gjeti dhe vendosi siç është theksuar në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Nga certifikata e pronësisë vërtetohet fakti se i padituri Xh.P. është pronar juridik i parcelave kontestuese ... dhe ...

Në seancën e shqyrtimit gjyqësor të 05.10.2021 u ftua të dëshmoj paditësi në cilësinë e dëshmitari H.P. i cili ka deklaruar se S.P. e ka vëlla gjithashtu edhe Xh.P. e ka vëlla , duke shtuar se parcela ... është pronë e bashkësisë familjar prej kur kanë qenë në bashkësi me mixhën O.P., që tani e trashëgon V.P. dhe pas luftës e kanë blerë atë pronë tre vëllezërit dhe e kanë bartur në emër të Xh., vëllezërit kanë propozuar që të jetë në emër të përbashkët por i njëjti pronën e ka bartur vetëm në emër të tij. Ndërsa parcela ... e kanë blerë pas luftës të tre vëllezërit nga B.K. dhe gjithashtu këtë pronë e kanë bartur në emër të Xh.. Në vitin 2019 kanë përgatitur të gjithë dokumentacionin dhe ka pasur të nënshkruar vetëm Xh. por i njëjti nuk

është lajmëruar dhe për këtë arsyeje nuk kanë mundur që të bëjnë ndarjen e pasurisë në rrugë jashtëgjyqësore. Në vitin 2018 i kanë ndarë mexhet me disa pika të plastikës dhe akoma i shfrytëzojnë ato prona.

Nuk është kontestuese se paditësit i kanë dërguar para të paditurit për blerjen e pronës, pasi një gjë e tillë vërtetohet në bazë të transaksionit bankar.

Në ekspertizën e gjeodezisë e punuar nga ekspertja F.B.L. ka konstatuar se sipas matjeve të bëra në terren me datë 02.03.2021 dhe përpunimit të matjeve në zyrë dhe të dhënave kadastrale konstaton se sipërfaqja e gjendjes faktike është prej 7793 m², gjegjësisht Parcela ... ZK Varosh me sipërfaqe prej 4209 m² dhe Parcela ... ZK Varosh me sipërfaqe prej 3584 m².

Nga vërtetimi i këtitillë i gjendjes faktike si dhe nga vetë deklaratat e palës paditëse në cilësinë e dëshmitarit, nga kontrata e shitblerjes së palujtshmërisë si dhe nga ekspertizë e ekspertes F.B.L., gjykata ka ardhur në përfundim se paditësit S. dhe H.P. në bazë të të gjithë provave të vërtetuara në shqyrtimin kryesor, janë pronar legjitim të këtyre patundshmërie në bazë të blerjes dhe mbajtjes si dhe duke u bazuar në nenin 28 paragrafi 4 të LTHMPJ, në të cilin është përcaktuar se “Personi i cili me mirëbesim e ka njëzet (20) vjet në posedim të pandërprerë një palujtshmëri ose një pjesë të saj, e fiton pronësinë në të”, andaj në rastin konkret paditësit e kanë fituar të drejtën në ngastrat kontestuese me parashkrim fitues dhe me shitblerje e cila gjë vërtetohet me faktin se paditësi dhe paraardhësit e tij juridik këtë patundshmëri e kanë mbajtur me mirëbesim që para 40 vitesh, dhe këtë të paditurit asnjëherë nuk e kanë kontestuar.

Gjykata në rastin konkret ka vlerësuar se janë plotësuar kushtet që kërkohen tek Bashkëndërgjyqësia dhe atë Neni 264 par.1 i LPK-së i cili përcakton se “*Padia mund të ngrihet bashkërisht nga shumë paditës ose kundër shume të pa diturve (bashkëndërgjyqësia) në rast se: pika a) në pikëpamje të objektit të kontestit janë në bashkësi juridike apo nëse të drejtat e tyre, përkatësisht detyrimet, burojnë nga e njëjta bazë faktike apo juridike (bashkëndërgjyqësia materiale), pika b) objekt kontesti janë kërkesat, përkatësisht detyrimet e të njëjtit lloj që mbështeten në bazën faktike dhe juridike esencialisht të njëjtë dhe po që se ekziston kompetenca lëndore dhe territoriale e të njëjtës gjykatë për secilën kërkesë dhe për secilin të paditur (bashkëndërgjyqësia formale)*”.

Gjykata i analizoi edhe theksimet e të paditurit, i cili i propozoj gjykatës që kërkesë padinë e paditësve ta refuzoj si të pa bazuar, këto theksime gjykata nuk i morri si të bazuara pasi që i padituri në asnjë moment nuk ka arritur që ti argumentoj theksimet e tij si me prova ashtu edhe në deklaratimet e tij gjatë seancave gjyqësore, andaj dhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata sa i përket shpenzimeve të procedurës vendosi sipas nenin.452.1 të LPK-së andaj ka obliguar të paditurin që të paguaj shpenzimet procedurale në shumën prej 730 euro, dhe atë për 3 seanca nga 135 euro për seancë, dhe për përpilim të padisë 104 euro, 21 euro për taksë gjyqësore dhe 200 euro për ekspertizë, në afat prej 15 dite nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi.

Lidhur me lartësinë e aprovuar të shpenzimeve të procedurës, gjykata është bazuar në rregulloren për tarifat e OAK-së.

Nga sa u tha më lart, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ
Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil
C.nr.791/19, datë 1 nëntor 2021

Gj y q t a r j a
Mirlinda Bytyqi Rexhepi

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij Aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditësh, nga dita e pranimit të këtij Aktgjykimi, Gjykatës së Apelit Prishtinë, nëpërmjet kësaj gjykate.